

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 8802 Kol.

Nr. 1288 Rep.



KONTRATE

SHIT - BLERJE KUOTASH

Sot me date 17.10. 2001 para meje Agim Robo, Noter i Dhomes se Noterise Tirane u paraqiten personalisht, shtetasit shqiptar, Irfan Hysenbelliu dhe Ismail Hoxha, ortake te Shoqerise "ALPTURIST" Sh.p.k. me cilesine e shitesit dhe shtetasi shqiptar Edmond Malollari, me cilesine e bleresit, te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj Kontrate Shit-Blerje kuotash me termat e meposhtem :

SHITESA : Irfan Hysenbelliu, i datelindjes 8. 04. 1959, lindur ne Skrapar dhe banues ne Tirane Ruga, "Pjeter Bogdani" P. 11. Ap. 6 Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. 299990.

Ismail Hoxha, i biri i Osmanit i datelindjes 25. 11. 1945, lindur dhe banues, ne Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. 0060487.

BLERES : Edmond Malollari, i datelindjes 04. 09. 1971 lindur ne Berat dhe banues ne Tirane me adrese Bulevardi "Zogu i Pare" Tirane Pall 69, person madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. 0229909.

OBJEKTI : Shitja e kapitalit themeltar ne masen prej 33. 33. %, te shoqerise tregtare "ALPTURIST" Sh.p.k.

PERMBAJTJA E KONTRATES

Shoqeria Tregtare "ALPTURIST" Sh.p.k. eshte rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane me Vendimin Nr. 16 986, date 05. 02. 1997.

Shoqeria eshte themeluar me nje kapital themeltar prej 500. 000 leke dhe me Ortake themelues shtetasit shqiptar, Ismail Hoxha dhe Irfan Hysenbelliu

Me vendimin e dates 28. 09. 2001 te asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare "ALPTURIST" Sh.p.k. eshte vendosur miratimi i shitjes se pjeses prej 33. 33 % te kuotave pjese e kapitalit fillestar te Shoqerise per bleresin Edmond Malollari.

Shitja e pjeses te shitesave, prej 33. 33. %, te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare "ALPTURIST", eshte e perbere nga humbja e se drejtes se pronesise ne menyre te barabarte te kuotave

te sejcilit ortak te kesaj shoqerie, si pasoje e miratimit te ketij transaksioni shitje, shprehur kjo ne vendimin e mesiperm te asamblese se ortakeve.

Shitesat, Ismail Hoxha dhe Irfan Hysenbelliu, jane plotesisht dakort dhe i shesin me vullnetin e tyre te lire dhe te plote **Bleresi** vleren prej 33. 33. % kuotave, ne menyre te barabarte, nga pjeset e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise tregtare "ALPTURIST" Sh.p.k.

Nga ana e vet **Bleresi** Edmond Malollari, eshte plotesisht dakort qe te bleje nga sejcili ne menyre te barabarte pjesen prej 33. 33. % te kuotave, pjese takuese te **Shitesave**, ne kapitalin themeltar te shoqerise "ALPTURIST" Sh.p.k.

MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE KUOTAVE.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate Shitesat Ismail Hoxha dhe Irfan Hysenbelliu, e humbasin pronesine e tyre ne menyre te barabarte, se bashku ne masen prej 33. 34 % ndersa **Bleresi** Edmond Malollari behet pronar i kesaj pjese, duke zevendesuar me te gjitha te drejtat por edhe detyrimet ortaket (shitesat) ne nhoqerine "ALPTURIST" Sh.p.k., ne pjeset e tyre takuese te perfituara nga ky transaksion shit - blerje.

Shoqeria tregtare "ALPTURIST" Sh.p.k., pas realizimit te kesaj kontrate, shit - blerje do te kete si ortak te saj : Ismail Hoxha me pjesmarje 33. 34 % te kuotave ne kapitalin fillestar, Irfan Hysenbelliu me pjesmarje 33. 33. % te kuotave ne kapitalin fillestar dhe Edmond Malollari, me pjesmarje 33. 33 % te kuotave ne kapitalin fillestar te Shoqerise.

ÇMIMI I SHITJES SE KUOTAVE.

Si cmim i ketij transaksioni te shit - blerjes se kuotave te Shoqerise tregtare "ALPTURIST" Sh.p.k. do te jete ai i vleres nominale te nje kuote, te percaktuar ne nenin 15 te Statutit te Shoqerise. Vlera nominale e nje aksioni eshte e barabarte me 5 000 leke.

Sipas ketij percaktimi bleresi paguan ne favor te shitesave shumen prej 166. 650 leke te ndare ne menyre te barabarte ndermjet tyre, shume e cila eshte paguar jashte kesaj zyre.

DISPOZITA TE FUNDIT

Kontrata hartohet ne pese kopjo te njejta, nje depozitohet ne Zyren e Rregjistrit Tregtar, nje kopjo depozitohet ne Aktet e Shoqerise, nje kopjo prane Zyres se Noterit ku edhe ajo u redaktua dhe nga nje kopjo palet.

Termat e Kontrates pasi u redaktuan prej meje Noteres iu bene te njohura paleve kontraktuese dhe cilat e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, ne prezencen time.

PALET

SHITES
Irfan Hysenbelliu

Irfan Hysenbelliu

BLERES
Edmond Malollari

Edmond Malollari

Ismail Hoxha

Ismail Hoxha

NOTER

Agim Robo

